



RËPUBLIKA E KOSOVËS
RËPUBLIKA KOSOVA
RËPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes Urgjente të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, nga data 21.03.2020 deri më datë 23.03.2020, në mënyrë elektronike.

Në mbledhje prezentuan(në votim dhanë votën):

1. Daut Azëmi, Kryësuës i Kuvendit
2. Mëhmëtali Krasniqi, anëtar
3. Nèhat Tèrpèza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtarë
6. Ramadush Tasholli, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Naim Stullca, anëtar
9. Majlinda Sylëjmani, anëtarë
10. Fatimë Krasniqi, anëtarë
11. Arif Miftari, anëtar
12. Xhyzidë Rrustëmi, anëtarë
13. Lulzim Rrustëmi, anëtar
14. Ramiz Qëriqi, anëtar
15. Argjënt Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturijë Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtarë
19. Shkëlzën Bislimi, anëtar
20. Albulëna Këlmëndi, anëtarë
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safëtë Amërllahu, anëtarë
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryëziu, anëtar
27. Ganimëtë Qëriqi, anëtarë
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtarë
30. Arbën Salihu, anëtar
31. Fëhmi Rëxhëpi, anëtar

Të tjerë prezënt:

1. Fauz Xhëmajli, nënkryëtar i Komunës
2. Avni Olluri, drëjtor i DA

3. Latif Ramadani DBF
4. Visar Kozhani zyrtar financiar
5. Diamant Bytyqi, zëdhënës i Komunës

Procësvërbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, përmes adresës elektronike tha, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Lipjanit,

Duke marr parasysh gjendjen emergjente në të cilën jemi për shkak të përhapjes së virusit COVID-19 edhe në Komunën tonë, më kërkesë të kryetarit të Komunës z. Imri Ahmeti jemi detyruar të thërrasim këtë mbledhje urgjente të kuvendit.

Duke marr parasysh vendimin e Qëvërisë nr. 01/07 të datës 11.03.2020 për anulimin e aktiviteteve publike, kjo mbledhje urgjente do të mbahet në formë elektronike për arsye që të mos kemi kontakte fizike si masë preventive nga përhapja e virusit COVID-19.

Në po ju dërgojmë ftesën dhe materialin për këtë mbledhje dhe po ashtu po ju bashkangjesisht linkun dhe mënyrën se si të jepni sygjërimë dhe të votoni.

Votimi dhe diskutimet do të bëhen në formë elektronike.

Afati i fundit për diskutime dhe votim do të jetë deri të hënën më 23.03.2020, ora 12:00. Pas kësaj kohe do të konsiderohet e mbyllur kjo mbledhje.

Të hënën pas orës 12:00 do të ju dërgojmë raportin me të gjitha votat dhe vërejtjet tuaja nëse do të këtë.

Ju lutemi përveç votimit që do ta bëni në link, kërkojmë nga ju të votoni secili veç e veç edhe përmes emailit në emailin nga ku është dërguar materiali.

Ju falënderim për mirëkuptim dhe për kontributin tuaj.

Mbësime me shpresë dhe lutemi që të kaloj kjo pandemi.

RËND DITË

1. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për ndihma familjeve në nevojë dhe nevojat tjera të menaxhimit të situatës emergjente nga covid -19

I

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për ndihma familjeve në nevojë dhe nevojat tjera të menaxhimit të situatës emergjente nga covid -19

Lidhur me këtë pikë antarët e kuvendit përveq që kanë të drejtë të votojnë mund të i shtojn edhe komentet e tyre.

Arif Miftari, të nderuar duke e ditë situatën në të cilën jemi jam për këtë propozim vendimi që të ndahen mjetet e lart cekura me qëllimin që t'u dilet në ndihmë të gjithë atyre që sot kanë më së shumti nevojë, si dhe rastet të cilat mund të na paraqiten si Komunë .

Duke u lutur për të gjithë popullin tim që këtë pandemi të Covid 19 ta kalojmë më sa më pak të infektuar.

Të ndikojmë edhe në rrethin ku jetojmë me keshilla për qëndrim në shtëpi sepse ata të cilët sot po përballen me këtë virus tani e kanë kuptuar se e vetmja mundësi për të i ikur infektimit është shmangja e vendeve publike, kontakti me individ të ndryshëm etj.

Të qëndrojmë në shtëpi dhe të respektojmë këshillat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike .

#Pa panik por më kujdes të shtuar

Me respekt

Bashkim Budakova, unë jam për këtë propozim vendimi.

Fatime Krasniqi, e mbështes këtë propozim vendim

Mehmetali Krasniqi, edhe unë e përkrahi këtë propozim vendim,Zoti na ndihmoftë të gjithë shqiptarëve

Arben Salihu, gjendja në të cilën jemi kërkon akoma më tepër po më lutje dhe shpresë te Zoti që sa më shpejt dhe më lehtë ta tejkalojmë këtë situatë.

Hyra Bytyçi, jam për Propozim Vëndimin për ndarjen e mjeteve financiare më qëllim të menaxhimit të situatës emergjente nga Pandemia Covid-19 në komunën e Lipjanit.

Egzona Fazlija, Nisma Socialsëmkokratë e përkrah këtë vendim.

Fadil Sopa, shumë më vend ky propozim vendim,Zoti na ndimoft të gjithëve.

Lumturije Bytyqi-Hasani, Fillimisht uroj që qytetarët e komunës sonë por edhe gjithë Kosova të kalojë sa më lehtë këtë gjendje pandemie.

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve për destinim në ndihmë familjevë më gjendje të rëndë, për ta kaluar këtë periudhë, është i qëlluar edhe pse paksa i vonuar.

Unë e lexova tëtë arsytimi që këto mjete mund të përdoren edhe për qëllime tjera për luftimin e COVID-19, dhe nëse komuna arrinë të mbulojë sadopak të gjitha familjet në nevojë me këto mjete, që duhet të jëtë qëllimi kryësor i këtyre mjeteve, por ka mbetje te mjeteve, propozoj mjetet e mbetura të përdoren për mjete shëndetësorë të dedikuara për luftimin e këtij virusi. Të kemi parasysh që kemi përsoneilin shëndetësor që i ekspozohët rrëzikut për t'u infektuar, dhe përkundër që ndoshta momentalisht janë ndërmarrë masat për sigurinë e shëndetit të tyre, por gjëndja mund të zgjatët, dhe nëvoja për mjete për masa do të jëtë ëvidëntë.

Përndryshë, unë ë përkrahë këtë propozim-vëndim dhe vota imë është PËR.

Fehmi Rexhepi, unë votoj për këtij propozim-vendimi.

Argjend Tasholli, vendim i duhur në kohen e duhur.

Afrim Miftari, Iniciativë që duhet përkrahur nga të gjithë asambleistet e KK Lipjan .Të jemi në përkrahje të njerëzve në nevojë duke shpresuar dhe lutur që kjo situatë të kalohet më lehtë dhe shpeëtë .Së bashku do ia dalim të fitojm luftën mbi këtë pandemi.Zoti e ruajtë popullin shqiptar dhe gjithë njerëzit e Globit

Lulzim Rrustemi, nësë mbrenda kësaj shume të mjeteve financiare prej 50.000.00 mijë euro (pesëdhjetë mijë euro) nuk nënkupton edhe mbulimin e nevojave për përsoneilin mjekësor për t'i dalë në ballë betejës së KOVID -19, pasi ka kërkesa për mbështetje të nëvojave shëndetësore për përsoneilin shëndetësor, është mirë të mbështësim dhe një shumë shtesë të mjeteve financiare për t'i mbulu këto nevoja,

Në emër të grupit parlamentar të PDK-së propozoj të ndajmë edhe një shum shtesë të mjeteve financiarë prej 20.000.00 eu (njëzet mijë euro), ekskluzivisht për mjetet mbrojtëse të nevojshme për përsoneilin shëndetësot të komunës së Lipjanit.

Drejtoria për financa le të vendos prej cilit kod buxhetor të tërhiqen këto mjete, si grup parlamentar keni aprovimin tonë. Ju përshëndes , kujdes PO! , panik Jo !

Ganimëtë Qëriqi, urojë sa më pak të kemi qytetarë të prekur më këtë virus vdëkjëpruës Covid-19 .

Duke vëzhguar situatën në tërsi të kësaj gjëndjeje çfarë po ndodhemi me mundësi shpërthimi të kësaj pandemie globale unë votoj për propozimin që të ndahen mjetet materjale të kërkuara nga KK Lipjanit.

Tani e vetmja masë e evitimit të kësaj pandemie ka mbetur masa e izolimit ose e karantëvizimit të pësonave të prekur ose dyshohet se janë prekur me Covid-19.

Dukë ditur kapacitetet shëndetësore e materiale të vendit tonë dhe të mos eskaloj situata duhët të respektohen masa strikte e vet izolimit .

Por ky izolim ka edhe kosto por familjeve në nevojë, duhët t'ju ndihmohet.

Ama i vetmi institucion që ka të pamundur vetizolimin është inst. Shëndetësor. Dihet se mjekët dhe infermieret janë drejtëpërdrejt në kontakt me këta persona. Unë kërkoj që këtij institucioni t'ju plotsohen kushtet preventive strikte, higjienike dhe sanitare adekuate... mjetet higjienike sanitare ta kenë interjerin adekuat ë jo të vendosur dosido. Arsyë së sa do që investojmë po qesë ka rrëgulla të gabuara dhe vendosën gabimisht masat preventivë janë të dështuara dhe pasojat mund të jenë katastrofalë edhe për mjekun dhe popullatën . Masat preventive duhet mos dështojnë. Kërkojmë interjer për vendosjen e higjienës dhe masat preventive adekuate mbrojtëse.

Manush Shamolli, Nisma e përkrah këtë propozim vendim.

Shkëlzën Bislimi, i nderuar Kryesues, Të nderuar kolegë, duke pasur parasysh gjendjen e jashtëzakonshme në të cilën ndodhemi, e që shpresoj të kalojë sa më parë, ne si grup i anëtarëve të Kuvendit Komunal nga radhët e Lëvizjes "Vetëvendosje!" jemi (Për) që të ndahen mjete financiare për familjet në nevojë, në mënyrë që ata të pakten mos ta kenë edhe brengen e ushqimit në këto ditë të vështira. Ne mendojmë së shuma prej 50 mijë eurosh është një shumë e vogël dhe duhët parë mundësinë e rritjes së kësaj shume edhe për 50 mijë euro të tjera; të ndihmohen edhe mjekët e infermierët me pajisjet elementare që ata për momentin nuk i kanë, e që janë më së të nevojshme në këtë situatë.

Duhët të kemi parasysh që qytetarët dhe stafi mjekësor, shpresën e vetme për ndihmë e kanë nga institucionet, e ne duhët t'u qëndrojmë afër me gjërat që atyre u nevojiten për t'i kaluar këto ditë të jo të zakonshme.

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret parasysh dhe të gjenden mundësitë buxhetore për rritjen e këtyre mjeteve në 100 mijë euro. Gjithashtu, pa marrë parasysh se cila shumë do të ndahet, 50 mijë osë 100 mijë euro, kërkojmë që të këtë transparencë të plotë sa i përket shpenzimit të këtyre mjeteve të mos lihet mundësia e dyshimit për çfarëdo keqpërdorimi të mundshëm.

Safete Amerllahu, votoj për aprovimin e vendimit.

Albulena Kelmendi, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal.

Së pari, shpresoj që të jeni mirë . Si pasojë e gjendjes së krijuar për shkak të pandemisë Covid-19, përveç votës për dhe propozimeve që do t'i merrni nga shefi i grupit parlamentar Shkelzen Bislimi, personalisht dua të ngris shqetësimin me furnizimin me ujë të pijshëm në fshatin Janjevë dhe fshatrat tjera të komunës sonë. Kërkoj nga Shtabi Emergjent dhe Kryetari i komunës që të ushtrojnë autoritetin ë tyre tek drejtues të KRU "Prishtina", me qëllim që në këto kohë të ndieshme qytetarët të mos përballen me mungesa të tilla elementare. Poashtu, kërkoj nga Drejtoria Komunale e Arsimit që të kontaktojë mësimdhënësit e komunës së Lipjanit me qëllim që secili të punojë me nxënësit e tyre nëpërmjet rrjeteve sociale apo platokrmave tjera të parapara nga DKA, që kështu nxënësit e komunës sonë të mos humbin më shumë mësim.

Si përfundim, pasi që dy javët e ardhshme po konsiderohen vendimtare në luftën kundër Covid-19, ju lutem të na kontaktoni për çfarëdo ndihmë që si anëtarë të Kuvendit mund ta japim. Detyra jonë si këshilltare komunale, të paguar nga paratë e taksave të qytetarëve, të jkakon idënë e të votuarit dhe asgjë më shumë.

Shëndët!

Egzona Bytyqi, sëmundja infektive-ngjitëse COVID-19, e cila tashmë mori karakter Pandemik, sigurisht që është situatë alarmante, dhe kërkon mirëmenaxhim, vigjilenc, gjithashtu mobilizim individual e institucional.

Karshi gjendjes aktuale, duke i ditur kapacitetet e niveleve shëndetësore me staf profesional, infrastrukture shëndetsore, teknologji e paisje mbrojtëse bazike, sidomos ato të nivelit Parësor Shëndetësor tek ne , më lutjen më të sinqertë nga kënd vështrimi profesional sygjeroj dhe

konsideroj që është e nevojshme të ndahen fonde të veqanta për Drejtorinë e shëndetësisë, është kohë e mos kursimeve materiale e financiare.

Për fund apeloj që t'i respektoni në përpikmëri që të gjithë rekomandimet zyrtare të OBSH-së, IKSHKP-së, njerëzve të tjerë kompetent kundër përhapjes së virusit.

Virus ky më shkallë të lartë të morbiditetit e mortalitetit !

Ukë Kryeziu, një vendim i domosdoshëm dhe i duhur në momentin që po kalojmë si pasojë e COVID-19. Besoj që këto mjete do të shkojnë në kohën dhe vendin e duhur pasi që është shumë më rëndsi. Unë propozoj që të identifikohen target grupet e shoqërisë që rrisin rrezikun e sëmundjes së lartë:

1. Përhapjen e virusit.

2. Por edhe vështërsitë sociale për t'u ballafaquar në këtë kohë të vështirë që po kalon i tërë vendi por edhe Komuna jonë.

Nazmi Krasniqi, duke marrë parasysh situatën unë e përkrahi këtë propozim vendim.

Ramiz Qeriqi, Përveq këtyre që janë duke marrë social, konsideroj që është e rëndësishme që të ndihmohen edhe ata që kanë qenë duke punuar privat e tani për momentin janë në karantinë, siqë dimë privatniku nuk jep rrogë, ju lutem të interesohet dikush që ata që janë duke mos marrë rrogë të ndihmohen. Më këto mjete të mbështetet edhe shëndetësisë nëse ka mundësi, po ashtu edhe bujqësia,

Daut Azëmi, të ndëruar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Lipjanit, më lejon të ju falënderoj të gjithëve për gatishmërinë tuaj dhe kontributin e dhënë rreth mbledhjes urgjente të ftuar në formë elektronike. Procesi i votimit ka përfunduar dhe të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit janë përgjigjur me votim për propozim vendimit. Pra konstatoj se më të gjitha votat për 31 vota aprohet: Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për ndihma të familjeve në nevojë dhe nevojat të tjera të menaxhimit të situatës emergjente nga pandemia covid-19.

Siq e dini kemi pas disa propozime nga ana juaj. Propozimi nga anëtarë i Kuvendit Lulzim Rustemi në emër të grupit të PDK-së, për të ndarë edhe një shumë shtesë 20.000 euro (njëzet mijë euro) ekskluzivisht për mjetet mbrojtëse të nevojshme për personelin shëndetësor të komunës së Lipjanit.

Këtë propozim e kemi shqyrtuar dhe sigurisht që është propozim me vend, por në propozimin që kemi patur për votim në shumë prej 50 mijë euro këtu janë paraparë edhe mbulimi i atyre kërkesave të shëndetësisë, po ashtu Drejtoria për Shëndetësi ka akoma mjete të mjaftueshme në kategorinë Mallra dhe Shërbime për të shfrytëzuar për nevojat e tyre. Në rast se ditëve në vazhdim rëndohet gjendja në të cilën jemi sigurisht që do të na duhet të gjejmë mundësinë për të ndarë mjete shtesë.

Tek propozim vendimi të cilin e keni pasur për shqyrtim dhe votim, nëni 3 sqaron zbatuesit e këtij vendimi e që janë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria e Shëndetësisë.

Po ashtu kemi pas edhe disa propozime tjera si ajo e Shkëlzen Bislimit dhe disa anëtarëve të tjerë e që është gati e njëjtë me propozimin e lartë cekur, edhe për këtë propozim arsyetimi është i njëjtë.

Urojmë që situata të qetësohet dhe mos të ketë nevojë në të ardhmen, në të kundërtën do të obligohemi që të ndajmë mjete tjera shtesë ashtu si kemi propozuar, por gjithmonë duke shikuar mundësitë buxhetore rreth këtyre veprimeve. Po ashtu po shprehim që Qeveria e Republikës së Kosovës të ndajë mjete për Komunitet për të i ndihmuar rreth kësaj situatë në të cilën gjendemi. Ju njoftoj se komentet dhe propozimet tuaja do të përbëjnë ekstraktin e kësaj mbledhje urgjente. Në fund më lejon edhe një herë të ju falënderoj të gjithëve për gatishmërinë tuaj që të jemi bashkë të gjithë për të tejkaluar këtë situatë në të cilën jemi. Po ashtu falënderim për sygjërimet tuaja dhe propozimet për marrjen e masave mbrojtëse rreth virusit COVID-19.

Mbesim me shpresë dhe lutemi që të kalojmë së bashku këtë pandemi.

Me respekt:

Daut Azemi

Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Mbledhja përfundoi (votimi i anëtarëve përfundoi) më datë 23.03.2020 në ora 12,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi